



VENDIM

Nr. 112 Datë 19.11.2014

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PER SHQYRTIMIN E KERKESES
PER MIRATIMIN E PLANIT TE INVESTIMEVE 2015 PER OST SH.A.**

Në mbështetje të neneve 9, 24, dhe 64të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 9 dhe 11 të Rregullores për Procedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga te Licensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës **19.11.2014**, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OST sh.a dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

Konstatohet se:

Nga studimi i materialeve të paraqitura nga OST sh.a. ka mangësi dhe plotësime që duhet të bëhen në mënyrë që Grupit të Punës së ngritur me urdhërin e Kryetarit të ERE-s Nr.74 dt 10.10.2014, t’i mundësohet një gjykim i drejtë për propozimin e miratimit të planit të investimeve.Për këtë arsye OST sh.a. –së I janë bërë me dije kërkesat e ERE-s për përmirësimin e dokumentacionit të aplikimit si më poshtë:

- Në zbatim të Nenit 7 paragrafi 3, kërkesa për miratim të planit të investimeve duhet të shoqërohet me një raport të zbatimit të planit paraardhës ku tregohet ecuria e investimeve të planifikuara dhe shpjegime rreth cdo ndryshimi.
- Viti 2014 është viti i fundit i periudhës së Tretë Rregullatore, e për këtë arsye është e nevojshme që të paraqitet njëraport i detajuar lidhur me Planifikim/Realizimin për periudhën 2012-2014.Duhet të paraqiten investimet e planifikuara/realizuara të vitit dhe do të shoqërohen me një shpjegues lidhur me investimet e parashikuara por që nuk janë realizuar dhe shpjegime për investimet e paparashikuara në planin e miratuar por të realizuara.
- Plani i Investimeve për vitin 2015 duhet të shoqërohet gjithashtu edhe me shpjegime e të dhëna të mjaftueshme lidhur me investimet afatgjata që planifikohen.

- Kerkohet që të dokumentohet miratimi i Planit të Investimeve 2015 nga Këshillat Mbikqyrëse përkatëse.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve,

Vendosi :

1. Të miratojë fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit të Investimeve 2015 për OST sh.a.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OST sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIM

Nr. 112 Datë 19.11.2014

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PER SHQYRTIMIN E KERKESES
PER MIRATIMIN E PLANIT TE INVESTIMEVE 2015 PER OST SH.A.**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundra
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____